



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

DATE/A:	11.01.2024
PËR/ZA/TO:	z. Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal në Komunën e Junikut
PËRMES/PREKTO/THROUGH:	z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunes së Junikut, Kryesues i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
NGA/OD/FROM:	z. Besart Tofaj - Nënkyetar i Komunes së Junikut, Koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Raport

I nderuar,

Në vijim ju përcjellim raportin e punës për vitin 2023 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ashtu siç është paraparë në planin e punës së Kuvendit Komunal të Komunes së Junikut për vitin 2023, raportimi në muajin Janar 2024.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi duke u bazuar në planin e punës për vitin 2023 i miratuar në Kuvendin Komunal të Komunes së Junikut, si dhe në nenin 11, pika 2 e udhëzimit administrativ Nr. 27/2012 MPb – 03/2012 MAPL, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka mbajtur gjashtë (6) takime të rregullta.

Në gjashtë (6) takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë diskutuar shumë qeshtje që kanë të bëjnë me dhe në fushën e sigurisë së përgjithshme, në fushën e shëndetësisë, arsimit, ambientit, Mjedisit Urban, Të drejtat e Njeriut.

Në takimin e parë (1) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut, Kodi i Etikës, personeli mjekësor, gjendja me barna dhe material esenciale në QKMF, Raport mbi përmasat zhvilluese të pandemisë Covid-19 për periudhën 2022 – 2023, Mesimi në kohë pandemie dhe shëndeti tek nxënësit e Komunes së Junikut, Diskutim mbi gjendjen e të moshuarve dhe hapat që duhet të ndërmerren nga Komuna e Junikut.

Në takimin e dytë (2) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut, Diskutim rreth vijueshmërisë së nxënësve në Komunën e Junikut, Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore, Kamerat e qytetit.

Në takimin e tretë (3) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut; Mirëmbajtja e shkollave, siguria në shkolla dhe përrreth objekteve shkollore, Informatë mbi ardhjen e bashkëatdhetarëve dhe siguria e përgjithshme.

Në takimin e katër (4) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut; Informatë mbi mbrojtjen e lumenjeve që rrjedhin në Komunën e Junikut, deponitë ilegale dhe mbeturinat, Gjendja e shkollave sipas rezultateve të arritshmërisë për klasat e 9-ta dhe maturës shtetërore; Prerja ilegale e pyjeve, gjuetia e paligjshme dhe peshkimi i paligjshëm; Siguria në trafik, parkingjet, sinjalizimi, sanimi i rrugëve dhe ndriçimi publik.

Në takimin e pestë (5) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut; Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve dhe gjelbërimi; Dëmtimi i shtëpive, vjedhja e gjesendeve, siguria në Komunën e Junikut dhe qentë endacak.

Në takimin e gjashtë (6) janë diskutuar këto pika: Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut; Diskutim rreth vijueshmërisë së nxënësve në Komunën e Junikut, Mbrojtja e grupeve të marginalizuara të cilat mund të privohen nga të drejtat themelore; Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve dhe gjelbërimi; Diskutim mbi riintegrimin e personave të riatdhesuar, Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2024.

Në gjashtë mbledhjet e rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë diskutuar dhe adresuar shumë kërkesa, shqetësime dhe iniciativa, ndër to:

Kodi i etikës, personeli mjekësor, gjendja me barna dhe materialet esenciale në QKMF – Junik

Nga Komuna e Junikut është bërë furnizimi me barna për QKMF-në në Junik dhe furnizim vazhdon edhe me tutje sipas kontratës së nënshkruar.

Mësime në kohë pandemie

Ashtu siç është e paraparë për dy shkollat është bërë furnizimi me materiale higjienike për higjienë dhe ambient të pastër.

Gjendja e të moshuarve

Mbi këtë temë jemi duke e hartuar një databazë me të dhënat e të moshuarve, duke u kujdesuar që të mos cenohet privatësia e tyre.

Siguria në shkolla

Është kërkuar dhe tashmë Policia është prezente në hyrje të shkollave, gjatë orarit që nënësit shkojnë si dhe gjatë orarit të kthimit nga shkolla.

Fushata vetëdijësuese kundër zjarreve

Është mbajtur fushatë vetëdijësuese për sensibilizimin e qytetarëve kundër zjarreve, duke ndikuar në mosndezjen e tyre dhe njohurit se si të bëhet raportimi i rasteve të tilla.

Rregullimi i komunikacionit në drejtim të shkollës fillore

Në kuadër të kësaj është caktuar vendndaljet e autobusit që bëjnë transportin e nxënësve si dhe me prioritet në këtë drejtim janë rregulluar tabelat e komunikacionit.

Kullosat, mbeturinat e djegura

Në kuadër të kësaj është mbajtur një fushatë sensibilizuese me qytetarëve që të ndalojnë djegia e fushave dhe kullosave. Ndërsa nga zyrtarët komunal për bujqësi dhe pylltari kanë treguar rëndësinë e ruajtjes së tokave bujqësore dhe ndikimin e tyre në mjedis.

Vijueshmëria e nxënësve në shkollë.

Gjatë kësaj kohe drejtori i DKRS-së dhe drejtores të shkollave janë angazhuar që vijueshmëria në shkollë të jetë sa më e mirë duke i trajtuar sfidat që prindërit mund të kenë pasur në raport me nxënësit por edhe në transportin e nxënësve.

Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore

Nga inspektoriat komunal bëhen kontrole të vazhdueshme në pika shitëse si dhe në pika tjera ku bëhet shitja e produkteve ushqimore dhe konform gjendjes në teren edhe janë marrur masat (gjoja).

Vendosja e kamerave në qytet dhe funksionalizimi i tyre

Gjatë vitin 2023 është angazhuar një kompani për mirëmbajtjen e kamerave dhe dërgimin e qendres së kontrollit të tyre në stacion policor në Janik, ndërsa për shkrimin e mbulueshmërisë së vëzhgimit me kamera për vitin 2024 është ndarë një buxhet nga buxheti komunal.

Lirimi i trotuareve nga veturat

Gjatë kësaj kohe nga Policia është tërhequr vërejtja për disa qytetarë dhe në rast të përsëritjes së veprës janë shqiptuar edhe gjoja e që ka ndikuar në vetëdijesimin e qytetarëve.

Mungesa e parkingjeve publike

Janë krijuar disa vend parkingje të reja dhe janë shënuar si të tilla me prioritet parkingje për persona me nevoja të veqanta.

Siguria në komunikacion (tejkalimi i shpejtësisë)

Nga Policia e Kosovës janë shtruar pikat e kontrollit si dhe janë ftuar Policia regjionale për patrullim me vetura inteligjente, dhe jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria e Infrastrukturës për lejin e vendosjes së disa pengesave në ato rrugë (rrugë regjionale).

Vendosja e sinjalizuesve vertikal dhe horizontal

Nga drejtoria e shërbimeve publike është bërë shenjëzimi i ri në vendkalimet për këmbësor, parkingje dhe shiritat ndarës në trafik.

Rrethimi i kanaleve të ujitjes në afërsi të shkollave

Është bërë rrethimi / mbulimi i një pjese të kanalit të ujitjes në afërsi të shkollës fillore.

Vendosja e shenjave (vertikale)

Nga drejtoria e shërbimeve publike është bërë rregullimi i shenjave të dëmtuara si dhe janë shtruar shenja të reja aty ku është konstatuar si të nevojshme.

Trajtimi i mbeturinave inerte

Komuna ka lëshuar një marrveshje me një kompani lokale për trajtimin e mbeturinave inerte edhe qytetarët përmes njoftimit në media janë njoftuar me adresën se ku duhet t'i dërgojnë mbeturinat inerte për trajtim të mëtutjeshëm.

Mirëmbajtja e lumenjeve

Është bërë mirëmbajtja e Lumit Erenik kryesisht me deblokimin e kanaleve anësore dhe largimin e barishteve drunjeve.

Deponit ilegale të mbeturinave

Në kuadër të mirëmbajtjes së hapësirave publike është bërë edhe pastrimi i disa deponive ilegale të mbeturinave dhe të njejtat zona janë rrethuar me shiritin përkatës për ndalimin e huthjes së mbeturinave.

Prerja ilegale e pyjeve

Pjesa e pyjeve që menaxhohen nga Komuna (pyjet private) janë në gjendje të mirë dhe prerja ka qenë e kontrolluar në ato vend ku ka pasur leje nga Komuna dhe të njejtat janë monitoruar nga rojet e pyllit.

Pastrimi i lumenjeve nga barishtat, ujërat e zeza dhe mbeturinat.

Këtë vit nga Komuna e Junikut janë realizuar dy projekte për kyqjen e shumë shtëpive ndërtuesave në sistemin e ujërave të zeza, pra nuk derdhen më në Lumit Erenik por në impiantin përkatës për trajtim të tyre. Ndërsa është bërë edhe mirëmbajtja e Lumit Erenik dhe Trava si pastrimi nga barishtat dhe drunjët e rrëzuar.

Fatkeqësitë natyrore (vërshimet),

Për të eliminuar bllokimet e mundshme të kanaleve e që mund të pasojnë me vërshime është bërë rregullimi i portave (presat) afër dhe në Lumit Erenik si dhe janë pastruar kanalet e kullimit.

Vjedhjet e shtëpive

Në Komunën e Junikut ka qenë vetëm një rast i kësaj natyre dhe me rastin janë duke u marrë organet e drejtësisë.

Qenë endacak

Qenë endacak janë mblidhur dhe vaksinuar (kastrim), ndërsa Komuna është në pritje të zgjedhjes së kësaj qeshije nga niveli qendror të cilët kanë hartuar edhe strategjinë e qenëve me dhe pa pronar.

Në mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi janë trajtuar edhe diskutuar edhe qeshije tjera e që pritet të adresohen për zgjedhje së bashku me nivelin qendror.